



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë, Korrik 2016

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”* dhe në zbatim të planit të mbikëqyrjes, me vendimin nr. 139, datë 30.12.2015, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”*, ka kryer mbikëqyrjen e përgjithshme në subjektin, Ministria e Punëve të Brendshme.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 960/1 prot., datë 30.12.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 960/2 prot., datë 30.12.2015, *“Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”*.

Ministria e Punëve të Brendshme është pjesë e aparatit organizativ të administratës shtetërore, organizimi dhe funksionimi i së cilës mbështetet në dispozitat e legjislacionit në fuqi e konkretisht, në Kushtetutën e RSH, ligjin nr. 9000/2003, *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”*; ligjin nr. 90/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”*, ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; urdhrin e Kryeministrit nr. 70, datë 07.05.2015, *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”*, i ndryshuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 98, datë 01.07.2015, *“Për disa ndryshime në urdhrin nr. 70, datë 07.05.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”* dhe Rregulloren e brendshme të miratuar me urdhrin nr.146/1, datë 31.07.2013 të titullarit të institucionit, *“Për miratimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Brendshme”*, i ndryshuar.

Subjekti ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil, me ligjin nr. 8549/1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*. Më tej, ky institucion ka vijuar të jetë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore. Sipas vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, lidhja nr. 1, në seksionin e listës së institucioneve të administratës shtetërore, parashikohet në mënyrë të shprehur se *“aparatet e ministrive”*, përfshihen në shërbimin civil si pjesë e institucioneve të administratës shtetërore.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit

nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Behare Hoxha, dhe Zamira Mujali, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Me shkresën nr. 960/3 prot., datë 15.06.2016 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 133/2 prot., datë 27.06.2016, “Mbi projektraportin e KMSHC-së”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar sëbashku me observacionet përkatëse, të cilat janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Nga ana e Komisionerit u analizua përmbajtja e observacioneve, si dhe e akteve që i shoqërojnë ato, u krahasuan me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të evidentuara në projektraport dhe qendrimi në lidhje me to, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit.

Me shkresën nr. 960/4 prot., datë 15.06.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast, nga ana e të cilit nuk janë paraqitur observacione.

Në këto rrethana, në kushtet kur janë respektuar kërkesat ligjore për zbatimin e procedurave u punua raporti përfundimtar i mbikëqyrjes.

Oëllimi i mbikëqyrjes:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për menaxhimin e burimeve njerëzore, Departamentit të Administratës Publike, Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit dhe njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.

- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes, verifikoi dosjen individuale për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil si dhe çdo dokument tjetër lidhur me çështje të personelit që rregullohen shprehimisht nga ligji për nëpunësin civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me *****, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm dhe ***** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si përgjegjës për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit.

Në këtë takim u bisedua dhe u ra dakord, për objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe dokumentacionin shkresor që do të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes. Një specialist i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, u caktua si person kontakti me grupin e punës.

- Grupi i punës shqyrtoi pozicionet e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organikës analitike të institucionit.
- Verifikoi dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- Verifikoi përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- Kontrollon të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës (*nivelin e edukimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë etj.*), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil, i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- U verifikuan materialet që pasqyrojnë planin vjetor të pranimin në shërbimin civil, rastet e plotësimit të vendeve të lira me procedurën e konkurrimit të hapur, procedurën e lëvizjes paralele dhe procedurën e ngritjes në detyrë, të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, vlerësimet e punës dhe shënimet që shoqërojnë ato, etj.
- Personave të ngarkuar për menaxhimin e shërbimit civil, iu kërkua që të paraqisnin problemet me të cilat ata ndeshen në praktikën e punës së përditshme, me qëllim që të asistohen teknikisht për zgjidhjen e drejtë të tyre.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete, të cilët janë të organizuar në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

Përmbajtja e Raportit:

I. Si është zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, në lidhje me deklarinimin e statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit

a) Organizimi i pozicioneve të shërbimit civil të institucionit.

Nga analiza dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, grupi i mbikëqyrjes konstaton se, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në dt. 26.02.2014), aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme, funksiononte në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me urdhrin nr. 190, datë 18.10.2013 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Më tej, rezulton se kjo strukturë ka ndryshuar me urdhrin nr. 226, datë 15.09.2014 të Kryeministrit, “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 190, datë 18.10.2013 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Në këtë rast, konstatohet se ndryshimet kanë prekur vetëm nivelin e funksionarëve politikë, (konkretisht bëhet fjalë për nëndarjen “Kabineti”, ku është shtuar një vend pune për pozicionin “Këshilltar për marrëdhëniet me parlamentin”).

Bazuar në strukturën dhe organikën që ishte në fuqi në dt. 26.02.2014, (që është data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar), rezulton se, Ministria e Punëve të Brendshme kishte gjithsej **153** vende pune, të organizuara si më poshtë:

- **9** pozicione pune, niveli i funksionarëve politikë, (ministër + 2 zv/ministër + 1 drejtor kabineti + 5 këshilltarë);
- **5** pozicione pune, punonjës me grada, (ndaj këtyre punonjësve, nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil);
- **16** pozicione pune, punonjës administrativë, (5 sekretare + 2 arkivist/protokollist + 1 arkivist + 1 magazinier + 5 pastrues + 2 punëtorë).
- **123** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës në fuqi	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë
1	Nëpunës civilë të kategorisë të lartë drejtuese	Sekretar i Përgjithshëm Drejtor Drejtorie të Përgjithshme	1 5 <i>Kjo kategori përbën 5 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
2	Nëpunës civilë të kategorisë të mesme drejtuese	Drejtor drejtorie	16 <i>Kjo kategori përbën 12 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
3	Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese	Përgjegjës Sektori Koordinator Inspektor	10 12 6 <i>Kjo kategori përbën 23 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
4	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialist	74 <i>Kjo kategori përbën 60 % të pozicioneve të shërbimit civil.</i>
	Pozicione të shërbimit civil gjithsej		123

Vërehet se, çdo njësi në strukturë është krijuar duke u mbështetur në parimin e hierarkisë administrative, ku vartësit, në çdo nivel, komunikojnë nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki. *Pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm*, në këtë rast, është në krye të të gjithë pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil.

Gjithashtu, drejtoritë e përgjithshme janë organizuar sipas drejtimeve kryesore funksionale, me nëndarje pozicionesh në “*drejtor drejtorie*” e më pas, “*përgjegjës sektori*” dhe “*specialist*”.

Në momentin e mbikëqyrjes, institucioni funksionon sipas strukturës së miratuar me urdhrin nr. 70, datë 07.05.2015 të Kryeministrit, “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme*”, të ndryshuar me urdhrin nr. 98, datë 01.07.2015, të Kryeministrit, “*Për disa ndryshime në urdhrin nr. 70, datë 07.05.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme*”. Për shkak të miratimit të kësaj strukture, institucioni ka kaluar në proces ristrukturimi. (*Ristrukturimi është trajtuar në vijim të këtij materiali, në pikën VI “Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit).*

Konkluzion:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj

të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil, siç janë: funksionarët politikë, punonjësit me grada dhe punonjësit administrativë.

- Numri i punonjësve për çdo njësi organizative, është brenda kufirit të miratuar me ligjin për administratën shtetërore.

b) Nëpunës të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, në datën e shtrirjes së efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014, procedura e ndjekur për punësim.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 67 “Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktualë”, rregullon statusin e nëpunësve dhe punonjësve që në momentin e fillimit të efekteve të këtij ligji ishin të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil. Në mënyrë më të shprehur, në pikat 3, 4 dhe 6, të këtij neni përcaktohet se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Më tej, vendimi nr. 116, datë 5.3.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë, që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kreun II “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, përcakton se:

“Nëpunës civilë” sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë të rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, apo njësia përgjegjëse, për institucionet e pavarura, verifikon procedurën e rekrutimit dhe lëshon për çdo nëpunës aktin e deklaramit të statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi”.

Për të evidentuar nëpunësit që kryenin funksione të shërbimit civil, në aparatit Ministrisë së Punëve të Brendshme, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, grupi i punës verifikoi dhe analizoi strukturën organizative dhe organikën e institucionit, që ishte në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit si dhe listëprezencën dhe listëpagesën e punonjësve për periudhën shkurt - mars 2014.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, në datën 26.02.2014, institucioni i mbikëqyrur, kishte **123** pozicione pune, të konsideruara pjesë e shërbimit civil ku, **111** prej tyre ishin të plotësuar (ose 90 % e pozicioneve të shërbimit civil) dhe **12** pozicione të shërbimit civil (ose 10 %) ishin vende të lira.

Më konkretisht, pozicione të shërbimit civil, vende të lira ishin:

- *Specialist në Sektorin e Koordinimit Operacional, Drejtoria e PMNZSH.*
- *Specialist, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët.*
- *2 pozicione pune për, Koordinator në Sektorin e Prokurimeve, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara.*
- *Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.*
- *Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.*
- *Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit dhe IT-së.*
- *Specialist në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.*
- *2 pozicione pune për Inspektorë në Sektorin e Inspektimit, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm.*
- *2 pozicione pune për Inspektorë në Sektorin e Kërkesë - Ankesave, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm.*

Në momentin e mbikëqyrjes rezulton se, disa nga këto pozicione janë plotësuar nëpërmjet procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe disa prej tyre janë riorganizuar për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Për 111 nëpunësit, që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në pozicione të shërbimit civil, u verifikuan dosjet e personelit; akti i emërimit në shërbimin civil sipas procedurave konkurruese të ligjit nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”; vendimi i konfirmimit si nëpunësit civil; dokumentet që vërtetënin plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe të kërkesave të posaçme për pozicionin përkatës; kohëzgjatja e periudhës së punësimit; si dhe, çdo dokument të administruar në dosjet e personelit.

Nga verifikimet e kryera konstatojmë se:

- **100 nëpunës** që kryenin funksione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit, të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Status i nëpunësit civil*”. Nëpunësit e këtij grupimi përbëjnë 90 % të të punësuarve në pozicione të shërbimit civil.
- **11 punonjës ekzistues**, ishin të punësuar me kontratë pune. Punonjësit e rekrutuar në këtë mënyrë, përbëjnë 10 % të të punësuarve në pozicione të shërbimit civil.

Konkluzion:

- Në përfundim të mbikëqyrjes, arrihet në konkluzionin se, subjekti i kontrolluar ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999, “*Status i nëpunësit civil*”, por në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri, 10 % e të punësuarve në pozicione të shërbimit civil, nuk ishin të rekrutuar sipas procedurave të përcaktuara nga ky ligj.

- Gjithashtu, edhe për nëpunësit të cilët ishin të rekrutuar nëpërmjet konkurrimit konstatohet se, në shumicën e rasteve fillimisht janë punësuar me kontratë pune dhe më pas janë realizuar procedurat e konkurrimit.

c) Nëpunës ekzistues të rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe të konfirmuar si nëpunës civilë.

Nga analiza dhe trajtimi i dokumentacionit që na u vu në dispozicion konstatohet se:

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në aparatin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishin **100** nëpunës të rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, ku:

- **82 nëpunës**, ishin me periudhë punësimi më shumë se 1 vit; dhe,
- **19 nëpunës**, ishin me periudhë punësimi më pak se 1 vit.

Për këta nëpunës, në mënyrë më të detajuar, konstatohet si më poshtë:

- **7 nëpunës civilë**, me periudhë punësimi më shumë se një vit, janë nëpunës ekzistues sipas përcaktimeve të kreut X, “Dispozita kalimtare”, neni 27 i ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”. Sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, punonjësit që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, punonin në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ishin nëpunës civil.

Këta nëpunës janë:

Nr.	Nëpunësi/Emër /Mbiemër	Emërtesa e pozicionit të punës
1.	*****	<i>Specialist</i> , Drejtoria e Planifikimit & Koordinimit të Emergjencave Civile
2.	*****	<i>Specialist</i> , Drejtoria Operacionale e Drejtimit Komandimit të Emergjencave
3.	*****	<i>Specialist</i> , Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
4.	*****	<i>Përgjegjës Sektori</i> , Sektori i Zbatimit të Buxhetit
5.	*****	<i>Specialist</i> , Sektori i Zbatimit të Buxhetit
6.	*****	<i>Specialist</i> , Sektori i Fondruajtjes dhe Shfrytëzimit të Materialeve
7.	*****	<i>Specialist</i> , Drejtoria e Koordinimit me Prefekturën

Grupi i punës verën se, nëpunësit si më sipër, kanë një periudhë punësimi mbi 15 vjet në shërbimin civil dhe kanë vijuar të kryejnë funksionet e tyre, në të njëjtën kategori punësimi, pa e zhvilluar më tej karrierën e tyre, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

- **75 nëpunës civilë**, me periudhë punësimi më shumë se një vit, janë të pranuar në shërbimin civil dhe të konfirmuar sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Për nëpunësit e këtij grupi, u konstatuan 3 raste, ku marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil ka pësuar ndryshime në drejtim të zhvillimit sistemit të karrierës, apo raste të aplikimit të procedurave gjyqësore gjatë saj. Në këtë rast, bëhet fjalë për nëpunësit:

*****, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (në dt. 26.02.2014), kryente detyrën “Specialist” në Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit, emëruar në këtë pozicion nëpërmjet konkurrencës së hapur, me aktin nr. 2159/9 prot., datë 21.05.2010, të Departamentit të Administratës Publike, (*konfirmuar si nëpunës civil, me aktin nr. 1769/2 prot., datë 23.11.2011*).

Në momentin e kryerjes së verifikimit rezultoi se, kjo nëpunëse kryente detyrën “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, emëruar në këtë pozicion me aktin nr.107 prot., dt. 12.01.2015, të DAP-it.

*****, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), kryente detyrën “Specialist” në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 3357/7 prot., dt. 23.09.2008 të Departamentit të Administratës Publike, (*konfirmuar si nëpunës civil, me aktin nr. 1654/2 prot., dt. 05.10.2009*). Në momentin e kryerjes së verifikimit rezultoi se, ky nëpunës, kryente detyrën “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 4595, dt. 29.09.2015, të DAP-it.

*****, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), kryente detyrën “Sekretar i Përgjithshëm”, pozicion pune të cilin e mban edhe në momentin e mbikëqyrjes. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, rezultoi se në këtë rast, me vendimin nr. 1433/1 prot., dt. 11.10.2013, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunësi është rikthyer në detyrën e mëparshme, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, (*vendim i Komisionit të Shërbimit Civil, nr. 668, dt. 08.11.2006, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 10, dt. 30.08.2008*).

Për **56 nëpunës të këtij grupi**, marrëdhënia e punësimit nuk ka pësuar ndryshime, pasi vazhdojnë të kryejnë funksione të shërbimit civil, në të njëjtën kategori punësimi, që i gjeti fillimi i efekteve të ligjit. Ndërsa **16 nëpunës të tjerë**, në momentin e verifikimit, kanë përfunduar marrëdhënien e punës me institucionin.

Nëpunësit civilë, që në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, ishin të rekrutuar me konkurrencë dhe ishin të konfirmuar si nëpunës civil, janë evidentuar në mënyrë individuale në **tabelën nr. 1**: “Punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ishin të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil dhe që janë rekrutuar dhe konfirmuar sipas procedurave të konkurrencës të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”. Tabela i bashkëngjitet raportit si pjesë e tij.

- **19 nëpunës të pranuar në shërbimin civil sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin nëpunës civilë në periudhë prove.**

Nga verifikimi i dosjeve të personelit, u konstatua se **për 1 nëpunës, marrëdhënia e punësimit ka pësuar ndryshime**, pasi fillimi i efekteve të ligjit e gjeti në një pozicion të kategorisë së ulët drejtuese, ndërsa në momentin e verifikimit, kryen funksione të nivelit të mesëm drejtues.

Bëhet fjalë për, nëpunësin *****, i cili, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, (në dt. 26.02.2014), kryente detyrën “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Jetësimit të Prioriteteve, në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik për Sigurinë Publike & Integritet, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 2047/9, dt. 14.01.2014 të Departamentit të Administratës Publike, (*konfirmuar si nëpunës civil me aktin nr. 2124/5 prot., dt. 15.06.2015*). Në momentin e kryerjes së verifikimit, ai kryen detyrën, Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik, (*emëruar në këtë pozicion me ngritje në detyrë, akt emërimi nr. 5556, dt. 12.11.2015*).

Për **12 nëpunës të këtij grupi**, marrëdhënia e punësimit nuk ka pësuar ndryshime, pasi vazhdojnë të kryejnë funksione të shërbimit civil, në të njëjtën kategori punësimi, që i gjeti fillimi i efekteve të ligjit, ndërsa **8 nëpunës të tjerë**, në momentin e verifikimit, kanë pezulluar ose përfunduar marrëdhënien me shërbimin civil.

Nëpunësit civilë, që në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, ishin të rekrutuar me konkurrim dhe ishin nëpunës civil në periudhë prove, janë evidentuar në **tabelën nr. 2**: “Punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ishin të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, që janë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe që ishin nëpunës civilë në periudhë prove”. Tabela i bashkëngjitet raportit si pjesë e tij.

d) Punonjës ekzistues të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, pa iu nënshtruar procedurave konkurruese, të parashikuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”..

Konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në aparatën e Ministrisë së Punëve Brendshme janë **11 punonjës të punësuar** me kontratë pune, ose me akt emërimi të përkohshëm, pra pa iu nënshtruar procedurave konkurruese të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Për këtë kategori punonjësish u konstatua se:

- **2 punonjës**, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar me kontratë pune, në të njëjtën kohë, kishin aplikuar edhe për procedurat e konkurrimit, të cilat, ishin në proces. Për këtë arsye, bazuar në nenin 68, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “Çdo procedurë tjetër në proces, nisur përpara shtrirjes së efekteve të këtij ligji, do të përfundojë sipas dispozitave të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, aktet e emërimit me konkurrim, kanë dalë pas datës dt. 26.02.2014).

Më konkretisht, evidentojmë se:

Punonjësja, *****, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryente detyrën “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Redaktimit Gjuhësor & Arkiv - Protokollit, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, emëruar në këtë pozicion me kontratën nr. 6408 prot., dt. 01.10.2013. Emërimi sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” është bërë me aktin nr. 737/7, dt. 07.03.2014. Në momentin e mbikëqyrjes, nëpunësja në fjalë, kryen detyrën “Përgjegjës Sektori” në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave, emëruar në këtë pozicion nëpërmjet lëvizjes paralele.

Punonjësja, *****, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryente detyrën “Drejtor” në Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit, emëruar në këtë pozicion me kontratën nr. 6349, dt. 30.09.2013. Emërimi sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, është bërë me aktin nr. 511/8, dt. 07.03.2014, të DAP-it. Më pas, nëpërmjet procedurës për ngritje në detyrë, është emëruar në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, (me aktin nr. 757/23, dt. 05.03.2015). Në momentin e verifikimit, nëpunësja, me kërkesë të saj, ka pezulluar marrëdhënien në shërbimin civil për një periudhë deri në 2 vjet, (akti nr. 3065/2 prot., dt. 07.07.2015, i njësisë përgjegjëse).

- ***Për 9 punonjës, që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil, dokumentacioni i vetëm që vërteton procedurën e marrjes në punë, është kontrata e punës, e lidhur me institucionin dhe e miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, sipas legjislacionit në fuqi. Grupi i punës, vëren se, për 6 punonjës të këtij grupi periudha e punësimit është më shumë se një vit, ndërsa për 3 punonjës periudha e punësimit është më pak se një vit.***

Në mënyrë më të detajuar, për këta punonjës konstatohet si më poshtë:

- *****, me kontratën nr. 1643/2 prot., dt. 25.02.2014, është punësuar në pozicionin, “Specialist në Sektorin e Jetësimit të Prioriteteve”, Drejtoria e Planifikimit Strategjik për Sigurinë Publike & Integritet.
- *****, me kontratën nr. 1644/2 prot., dt. 25.02.2014, është punësuar në pozicionin “Koordinator në Sektorin Teknik”, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara.
- *****, me kontratën nr. 1637/2 prot., dt. 25.02.2014, është punësuar në pozicionin “Koordinator” në Njësinë Antitrafik.
- *****, me kontratën nr. 7833/2 prot., dt. 14.11.2013, është punësuar në pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.
- *****, me kontratën nr. 21/12 prot., dt. 11.03.2008, është punësuar në pozicionin “Specialist në Sektorin Juridik”, Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Prokurimeve.
- *****, me kontratën nr. 9100/4 prot., dt. 20.02.2014, është punësuar në pozicionin, “Drejtor” në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave.

- *****, me kontratën nr. 343/2 prot., dt. 27.01.2014, është punësuar në pozicionin, “Inspektor në Sektorin e Inspektimit”, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm.
- *****, me kontratën nr. 3324 prot., dt. 20.08.2008, është punësuar në pozicionin, “Specialist” në Drejtorinë e Koordinimit me Prefekturat.
- *****, në dt. 26.02.2014 mbante pozicionin, “Specialist në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit”, Drejtoria Juridike dhe e Përafrimit të Legjislacionit, punësuar në këtë pozicion me kontratën nr. 2659, dt. 20.09.2010. (Në momentin e mbikëqyrjes ka përfunduar marrëdhënien e punësimit nëpërmjet dorëheqjes, vendim i Sekretarit të Përgjithshëm nr. 6802/2 prot., dt. 15.09.2015).

Konstatime:

- Në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, janë 2 punonjës me “Emërim për zëvendësim leje lindje”. Këta punonjës, nuk konsiderohen “punonjës ekzistues” pasi, si të tillë paraqiten dy nëpunëset që ishin me leje lindje.

Në këtë rast bëhet fjalë për:

*****, me kontratën nr. 9152/3, dt. 20.01.2014 është punësuar në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm”, me afat punësimi deri në kthimin nga leja e lindjes e punonjësës ***** (***** me leje lindje nga dt. 20.01.2014 – 01.02.2015);

*****, me kontratën nr. 1638/1, dt. 25.02.2014, është punësuar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Planifikimit të Buxhetit”, Drejtoria e Financës, me afat punësimi deri në kthimin nga leja e lindjes të punonjësës ***** (***** me leje lindje nga dt. 25.02.2014 – 31.01.2015). Në momentin e mbikëqyrjes, punonjëset zëvendësuese, kanë ndërprerë marrëdhënien e punës sipas afateve të përcaktuara në kontratën e punës.

- **26 punonjës**, që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në pozicione të shërbimit civil, në momentin e verifikimit kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare me institucionin, (15 me lirim nga shërbimi civil nëpërmjet dorëheqjes, 4 largime nga shërbimi civil si masë disiplinore, 4 kanë pezulluar marrëdhënien në shërbimin civil për një periudhë deri në 2 vjet, 1 nëpunës nëpërmjet ngritjes në detyrë ka kaluar në një institucion tjetër të shërbimit civil).

Në mënyrë më të detajuar këta nëpunës janë trajtuar në vijim të materialit, përkatësisht në pikat ku kemi trajtuar pezullimin nga shërbimin civil, largimin nga shërbimi civil si masë disiplinore dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

- e) **Procedura e deklaramit të statusit të punësimit, për nëpunësit dhe punonjësit, që kryenin funksione në shërbimin civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 4, shkronja “f”, Departamenti i Administratës Publike, paraqitet si njësi përgjegjëse për institucionin e

mbikëqyrur. Ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij e ngarkojnë njësinë përgjegjëse me disa detyra dhe përgjegjësi nga ky ligj apo në bazë të tij.

Një nga detyrat që ligji i ngarkon njësisë përgjegjëse, është deklarimi i statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit të cilët në datën e fillimit së efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicione të shërbimit civil.

Më konkretisht, pika 6 e nenit 67, të ligjit, nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, përcakton se, *“Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”*.

Më tej, në mbështetje të pikës 8, të nenit 67 të ligjit, është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (ndryshuar me vendimin nr. 532, datë 06.08.2014 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr. 627, dt. 24.09.2014 të Këshillit të Ministrave)*.

Në këtë akt normativ janë përcaktuar procedurat e hollësishme, që duhet të kryejë njësia përgjegjëse, për të realizuar deklarimin e statusit të punësimit për punonjësit dhe nëpunësit aktualë, si dhe afatin brenda të cilit duhet të përfundojë i gjithë ky proces. Në kreun IV, pika 1, të vendimit si më sipër është përcaktuar se: *“Procedura e deklarimit të statusit të punësimit përfundon jo më vonë se 120 (njëqind e njëzetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi”*. Më tej, pika 2 përcakton se: *“... Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk mund të jetë më vonë se data 30 tetor 2014”*.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në Ministrinë e Punëve të Mbrendshme, grupi i punës nuk arriti që të dokumentojë materiale shkresore, që të provojnë kryerjen e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit apo shtyrjen e saj për shkaqe të arsyeshme.

Por, nga ana tjetër, gjatë verifikimit të dosjeve të personelit u konstatua se, për nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil, janë kryer disa procedura në lidhje me marrëdhëniet tyre të punës në shërbimin civil, ku rezulton se ata janë trajtuar si nëpunës civilë, me të drejtat dhe detyrat e tyre. Ndër këto veprime përmendim:

- Transferimi i përhershëm i nëpunësve civilë në një pozicion tjetër të shërbimit civil për shkak të ristrukturimit. Në këtë rast, njësia përgjegjëse (DAP-i), ka krijuar komisionin e ristrukturimit i cili ka shqyrtuar dhe propozuar mundësinë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Më tej, pas marrjes së propozimeve, është vijuar me nxjerrjen e vendimit për transferimin nëpunësve të prekur nga ristrukturimi.
- Nëpunësit dhe punonjësit me periudhë punësimi më pak se një vit, kanë kryer detyrimet e periudhës së provës dhe në përfundim eprori direkt përkatës ka nxjerrë vendimin e konfirmimit si nëpunës civil.
- Mos respektimi i procedurës formale të nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të punësimit, nuk i ka penguar nëpunësit që të aplikojnë për procedurat e lëvizjes paralele dhe ato të ngritjes në detyrë, apo të zhvillojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj.

Pra, në këto raste, pavarësisht se procedura e deklarimit të statusit të punësimit nuk është kryer, vihet re se, njësia përgjegjëse (*DAP-i*), komisioni i ristrukturimit i parashikuar nga ligji si një trupë e posaçme që realisht shqyrton mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi në kuadër të ristrukturimit, dhe eprorët direkt, i kanë trajtuar punonjësit, sipas rastit, “*nëpunës civilë*”, apo “*nëpunës civilë në periudhë prove*”.

Konkluzion:

- Nga mbikëqyrja e kryer, arrihet në përfundimin se, për të gjithë ata nëpunës që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, kryenin funksione në shërbimin civil, pranë institucionit të mbikëqyrur, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për këtë institucion, nuk e ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.
- Por, nga ana tjetër, pavarësisht faktit që, nuk ka një akt formal të deklarimit të statusit të punësimit, në procedurat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e shërbimit civil, punonjësit sipas rrethanave të secilit, rast pas rasti, janë konsideruar “*nëpunës civilë*”, ose “*nëpunës civilë në periudhë prove*”.

II. Procedura dhe formati i përshkrimit të punës

a) Procedura e ndjekur për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë të përcaktuara rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, në kreun IV “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*” (pika 14), përcakton se:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, për periudhën objekt kontrolli, evidentojmë dy momente që kanë diktuar nevojën e hartimit të përshkrimeve të reja të punës.

Së pari, përshkrimet e punës janë hartuar pas miratimit dhe fillimit të efekteve të legjislacionit të ri të shërbimit civil, (*ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore në zbatim të tij*).

Vendimi nr. 142, datë 12.03.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, në kreun VI “Dispozita tranzitore”, pika 40, ka parashikuar që, të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, të përfundojnë hartimin e përshkrimit të punës, deri në datën 1 korrik 2014.

Së dyti, përshkrime të reja pune, janë hartuar për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Me urdhrin nr. 70, datë 07.05.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Minsitrisë së Punëve të Brendshme”, është miratuar struktura dhe organika e re për aparatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Miratimi i strukturës së re, është shoqëruar me ristrukturim të institucionit dhe në këtë kuadër, 50 pozicione pune të shërbimit civil kanë pësuar ndryshime.

Nga verifikimi rezultoi se, përshkrimet e punës janë hartuar sipas formatit standard të miratuar dhe janë nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, eprori direkt dhe nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, sipas pikës 4.2.10, të udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Por, nga ana tjetër, në pikën 19 të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, është parashikuar se Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, kthen për rishikim përshkrimet e punës për pozicionet respektive, në rast se vëren se ato, nuk janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.

Mbështetur në sa parashikohet në këtë pikë, nënvizojmë se, e drejta e Departamentit të Administratës Publike, për të rikthyer për rishikim përshkrimet e punës, nënkupton edhe detyrimin e këtij organi për të aprovuar në mënyrë shkresore rregullshmërinë e përshkrimeve të punës, duke e bërë me dije zyrtarisht Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit, se përshkrimet e punës janë në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, me qëllim që ai të vijojë me procedurën e miratimit dhe të depozitimit të tyre pranë Departamentit të Administratës Publike.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në këtë rast u konstatua se, procedura e bashkëpunimit ndërmjet strukturave/nëpunjësve përgjegjës për realizimin e këtij procesi, që janë analist pune, epror direkt i pozicionit përkatës/Departamenti i Administratës Publike, janë realizuar vetëm në formë elektronike. Përshkrimet e punës janë plotësuar në një sistem të veçantë “google drive”, të administruar nga njësia përgjegjëse (DAP-i). Nëpërmjet këtij sistemi, njësia përgjegjëse ka asistuar nëpunësit e ngarkuar për hartimin e përshkrimeve të punës duke iu dhënë sugjerimet e nevojshme teknike. Në vijim, i gjithë procesi rezultoi të jetë zhvilluar në format elektronik dhe në përfundim, përshkrimet e punës janë printuar nga sistemi dhe janë nënshkruar.

Vlerësojmë se, dokumentimi i veprimeve të të gjitha hallkave në këtë rast, nëpërmjet akteve shkresore, është i nevojshëm si për të provuar përmbushjen e detyrës në mënyrën dhe kohën e duhur nga secila prej tyre, ashtu edhe për të mundësuar Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit për të finalizuar procesin, si strukturë pasardhëse dhe e vendosur në rolin e miratuesit për të vijuar me procesin e miratimit dhe të depozitimit të tyre pranë njësisë përgjegjëse. Komunikimi

në mënyrë elektronike në këtë rast, siguron lehtësi dhe shpejtësi në komunikim, por përdorimi i tij, nuk e justifikon mosdokumentimin e procesit, në formën shkresore dhe zyrtare.

Nisur nga observacionet që subjekti i mbikëqyrur ka paraqitur në lidhje me këtë pikë të projektraportit, Komisioneri vëren se, nga ana e institucionit është pretenduar se, përshkrimet e punës janë hartuar në një format elektronik të administruar nga DAP-i dhe analisti i punës ka reflektuar çdo ndryshim apo korigjim të sugjeruar prej tij.

Vlerësojmë se, bashkëpunimi në sistemin elektronik “*google drive*”, ndërmjet analistit të punës dhe specialistit të DAP-it ka të bëjë vetëm me fazën krijimit apo hartimit të përshkrimeve të punës që është faza e parë e këtij procesi.

Sjellim në vëmendje se, konstatimet tona kanë të bëjnë me fazat e mëtejshme të procesit siç është, dhënia e mendimit të njësisë përgjegjëse lidhur me përputhshmërinë e përshkrimeve të punës me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar dhe fazën e fundit që është administrimi i përshkrimeve të punës ku një kopje e dokumentit përfshihet në dosjen e personelit të çdo nëpunësi, (*në rastin e vendeve të lira një kopje e përshkrimit të punës për secilin pozicion i bashkëngjitet planit të rekrutimit*), një kopje e përshkrimeve të punës depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike. Në këtë mënyrë përshkrimet e punës bëhen pjesë e akteve rregullative në bazë të të cilave është i organizuar dhe funksionon institucioni, siç janë, struktura dhe organika në fuqi e institucionit, rregullorja e brendshme e institucionit etj. Kjo për faktin pasi, vetë akti nënligjor, (*VKM nr. 142, dt. 12.03.2014, i ndryshuar*), ka parashikuar se përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime, ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni.

Në lidhje me përmbushjen e kërkesave të vendit të punës, nga përmbajtja e aktit të përshkrimit të punës, konstatohet se, në ndarjen “*Kërkesa të posaçme*”, janë përcaktuar kërkesat specifike të vendit të punës në lidhje me *nivelin e edukimit dhe fushën kryesore të studimeve; përvojën në punë e përcaktuar në terma kohorë dhe pozicion përkatës; si dhe njohuritë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për përmbushjen e funksionit të pozicionit të punës.*

Nga të dhënat e administruara, të cilat pasqyrohen në tabelën “*Aneksi*”, bashkëlidhur raportit, rezulton se nëpunësit i plotësojnë këto kërkesa.

Konkluzion:

- Komisioneri arrin në përfundimin se, procesi i hartimit dhe miratimit të përshkrimeve të punës është një procedurë administrative, kryerja e së cilës kërkon respektimin e rregullave dhe të afateve të vendosura në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “*Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil*”.
- Në kushte të tilla ku, e gjithë praktika e administrimit të këtij procesi, është realizuar vetëm në format elektronik, i kërkojmë njësisë përgjegjëse dhe institucionit të

mbikëqyrur që, në çdo rast, për procedurat që kanë lidhje me menaxhimin e shërbimit civil, duhet të bëhet administrimi i tyre edhe në mënyrë shkresore.

- Administrimi në formë shkresore i procesit është i domosdoshëm jo vetëm si kërkesë e ligjit por edhe me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil nga nëpunësit përgjegjës.

III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, në të cilin është përcaktuar se, mbikëqyrja përfshin ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, për periudhën kohore nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar e në vijim, grupi i punës verifikoi planifikimin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil për vitin 2015 dhe për vitin 2016.

Konstatohet se, planifikimi i nevojave për rekrutim në shërbimin civil, në institucionin e mbikëqyrur, është realizuar duke u bazuar në përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Mbështetur në këto akte ligjore dhe nënligjore, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka hartuar planin e nevojave për rekrutim për aparatën e ministrisë dhe institucionet në varësi si: Drejtoria e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Prefektura e Qarkut Berat, Prefektura e Qarkut Dibër, Prefektura e Qarkut Durrës, Prefektura e Qarkut Elbasan, Prefektura e Qarkut Fier, Prefektura e Qarkut Gjirokastrë, Prefektura e Qarkut Korçë, Prefektura e Qarkut Kukës, Prefektura e Qarkut Lezhë, Prefektura e Qarkut Shkodër, Prefektura e Qarkut Vlorë, Nënprefektura Kavajë, Nënprefektura Lushnjë, Nënprefektura Sarandë.

Për vitin 2015 rezulton se, plani i nevojave për pranim i është dërguar Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 7808/11 prot., datë 05.12.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për vitin 2016 rezulton se, plani i nevojave për pranim i është dërguar Departamentit të Administratës Publike me shkresën nr. 876/1 prot., datë 13.01.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Plani i nevojave për rekrutim për vitin 2016 parashikon:

Për aparatën e ministrisë, është planifikuar që të shpallet konkurrimi për **26** pozicione të shërbimit civil, (3 pozicione për drejtor drejtorie, 5 pozicione për përgjegjës sektori, 3 pozicione për koordinator, 1 pozicion për inspektor, 14 pozicione për specialist). Procedurat e konkurrimit për plotësimin e vendeve të lira sipas planit vjetor të pranimit, në momentin e mbikëqyrjes, janë në fazën e publikimit nga njësia përgjegjëse.

Për institucionet e varësisë, është planifikuar që të shpallet konkurrim për 54 pozicione të shërbimit civil, (2 pozicione për sekretar të përgjithshëm, 14 pozicione për përgjegjës sektori/inspektor, 38 pozicione për specialist). Për institucionin e Drejtorisë së Policisë së Shtetit, nuk janë planifikuar rekrutime në shërbimin civil, për vitin 2016, pasi ky institucion nuk ka paraqitur nevoja për rekrutim.

IV. Rekrutime, lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi emërimet në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur, emërimet në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë si dhe emërimet e nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese.

Konstatohet se, për periudhën objekt mbikëqyrje, nga data 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e deri në momentin e mbikëqyrjes, Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për institucionin e kontrolluar ka nxjerrë 35 akte emërimi, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Në mënyrë më të detajuar konstatohet si më poshtë:

- Procedura konkurrimi të nisura sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, që fillimi i efekteve të ligjit të ri, i gjeti në proces.

Në 6 raste, emërimet janë kryer në përfundim të procedurave të konkurrimit, të parashikuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, (i shfuqizuar). Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit të ri, këto procedura ishin të papërfunduara. Për këtë arsye, bazuar në nenin 68, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, ku përcaktohet se “Çdo procedurë tjetër në proces, nisur përpara shtrirjes së efekteve të këtij ligji, do të përfundohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, për këtë grup nëpunësish, aktet përkatëse të emërimit, kanë dalë përgjatë periudhës mars - prill 2014.

Konkurrimet, që hyrja në fuqi e ligjit i gjeti në proces, janë:

- Konkurrimi për “Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme”, me aktin nr. 513/8, dt. 07.03.2014 të Departamentit të Administratës Publike është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësja *****.
- Konkurrimi për “Specialist në Drejtorinë e PMNZH”, me aktin nr. 766/8, dt. 04.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësja *****.
- Konkurrimi për “Specialist në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët”, me aktin nr. 514/8, dt. 07.03.2014 të Departamentit të Administratës Publike është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësi *****.
- Konkurrimi për “Drejtor në Drejtorinë e Komunikimit dhe IT”, me aktin nr. 736/7, dt. 07.03.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësi *****.

- Konkurrimi për “Përgjegjës në Sektorin e Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv-Protokollit”, me aktin nr. 737/7, dt. 07.03.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësja *****.
- Konkurrimi për “Inspektor në Sektorin e Inspektimit”, me aktin nr. 763/8, dt. 19.03.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nëpunësi *****.

Në rastet e përmendura më sipër, bazuar në nenin 68, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se, procedurat e konkurrimit janë përfunduar sipas dispozitave të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Bazuar në vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreu IV, “Dispozita tranzitore”, pika 4 e 5, afati i periudhës së provës dhe procedurat e vlerësimit në fund të kësaj periudhe për këta nëpunës, janë finalizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- Emërimet kryera në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt mbikëqyrje, janë **29** emërimet kryera sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Nga verifikimi i procedurës së ndjekur për plotësimin e vendeve të punës, që kanë rezultuar të lira konstatojmë se:

- **15 pozicione**, janë plotësuar, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, me konkurrim të hapur;
- **5 pozicione**, janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, (4 lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive dhe 1 lëvizje paralele në kategorinë e ulët drejtuese).
- **7 pozicione**, janë plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë, (5 ngritje në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese, 2 ngritje në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese).
- Në **2 raste**, është bërë plotësimi i një vendi të kategorisë së lartë drejtuese me anëtar të TND-së.

Në mënyrë më të detajuar për secilën procedurë të ndjekur për plotësimin e vendeve të lira konstatojmë se:

- **Emërimet, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.**

Bazuar në planin vjetor të pranimit, Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse për institucionin, ka realizuar procedurën e rekrutimit, (ka publikuar procedurën e pranimit, ka krijuar Komitetin e Përherëshëm të Pranimit, ka realizuar procedurën e konkurrimit) dhe pas marrjes së miratimit zyrtar nga kandidati fitues, ka nxjerrë aktet përkatëse të emërimit, drejtuar kandidatit dhe institucionit.

Nëpunësit e emëruar nëpërmjet kësaj procedure i kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

Emërimet në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive:

Nr.	Nëpunësi Emër/ Mbiemër	Pozicioni i punës i planifikuar për pranim	Akti i emërimit i nxjerrë nga DAP-i
1	*****	Specialist në Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Analizës	Akti nr. 4545/2, dt. 25.09.2015
2	*****	Specialist në Sektorin e Koordinimit dhe Raportimit të Politikave Integruese	Akti nr. 288, dt. 21.01.2015
3	*****	Specialist në Drejtorinë e Azilit	Akti nr. 6654, dt. 30.12.2015
4	*****	Specialist në Drejtorinë e Azilit	Akti nr. 6655, dt. 30.12.2015
5	*****	Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Burimeve Njerëzore	Akti nr. 237, dt. 19.01.2015
6	*****	Specialist në Sektorin Shërbimeve Juridike	Akti nr. 5939, dt. 26.11.2015
7	*****	Specialist në Sektorin Hartimit të Legjislacionit	Akti nr. 168, dt. 13.01.2016
8	*****	Specialist në Sektorin e Përfaqësimit dhe Përafrimit të Legjislacionit	Akti nr. 4371/4, dt. 17.09.2015
9	*****	Specialist në Drejtorinë e Komunikimit dhe IT	Akti nr. 5932, dt. 26.11.2015
10	*****	Specialist në Drejtorinë e Komunikimit dhe IT	Akti nr. 5935, dt. 26.11.2015
11	*****	Specialist në Drejtorinë e Komunikimit dhe IT	Akti nr. 5934, dt. 26.11.2015
12	*****	Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave	Akti nr. 6656, dt. 30.12.2015
13	*****	Specialist në Sektorin e Mbështetjes Operacionale & Trajnimeve	Akti nr. 507/2, dt. 26.12.2015
14	*****	Specialist në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar	Akti nr. 6065, dt. 04.12.2015
15	*****	Specialist në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar	Akti nr. 6066, dt. 04.12.2015

Nisur nga kërkesat ligjore, për këtë kategori specifike të nëpunësve civilë në periudhë prove, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, për nëpunësit më sipër, duhet të kujdeset për të zbatuar të gjitha detyrimet që parashikon ligji për nëpunësin civil në periudhë prove, duke përfshirë kryerjen e ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP), caktimin e një punonjësi më të vjetër për t'u kujdesur, si dhe vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe pas kësaj të shprehet për konfirmimin ose jo në pozicionin përkatës të punës.

- **Emërime, nëpërmjet lëvizjes paralele, (4 lëvizje paralele në kategorinë ekzekutive dhe 1 lëvizje paralele në kategorinë e ulët drejtuese).**

Në mënyrë më të detajuar konstatojmë se, nëpërmjet lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive janë bërë këto emërime:

*****, me aktin nr. 4546, dt. 25.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Monitorimit të Buxhetit*”, në Drejtorinë e Financave. (Nëpunësi ka ardhur nga një institucion tjetër i shërbimit civil, nga Bashkia Shkodër).

*****, me aktin nr. 4547, dt. 25.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Aktiveve*”, në Drejtorinë e Financave.

*****, me aktin nr. 4864, dt. 13.10.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shtetësisë*”, në Drejtorinë Juridike. (Nëpunësi ka ardhur nga institucion i varësisë, nga AITPP).

*****, me aktin nr. 5853, dt. 24.11.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Specialist në Drejtorinë Operacionale e Drejtim Komandimit të Emergjencave*”. (Nëpunësi ka ardhur nga institucion i varësisë, nga AITPP).

- Emërime në kategorinë e ulët drejtuese nëpërmjet lëvizjes paralele:

Për periudhën objekt mbikëqyrje, nëpërmjet lëvizjes paralele në kategorinë e ulët drejtuese, është kryer vetëm një emërim. Në këtë rast bëhet fjalë për:

*****, me aktin nr. 5398, dt. 05.11.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave*”, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave.

Nga trajtimi i dokumentacionit të administruar në dosjet e personelit, u konstatua se:

Bazuar në planin vjetor të pranimit, Departamenti i Administratës Publike ka publikuar shpalljen për vendet e lira që do të plotësoheshin nëpërmjet lëvizjes paralele.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve të cilët përmbushnin kushtet e lëvizjes paralele.

Sekretari i Përgjithshëm i institucionit ka ngritur komisionin e brendshëm, ku përbërja e tij ka ndryshuar në varësi të eprorit direkt, që është parashikuar si një nga tre anëtarët e këtij komisioni.

Më tej, komisioni i brendshëm ka vijuar me vlerësimin me pikë të kandidatëve për dokumentacionin e dorëzuar, (vlerësimin për përvojën, trajnimet apo kualifikimet si dhe për certifikimin pozitiv), dhe vlerësimin për intervistën me gojë.

Konstatohet se, për këtë procedurë në çdo rast ka paraqitur dokumente vetëm një kandidat, i cili është kualifikuar dhe ka marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Vendimi për përzgjedhjen e

kandidatit fitues i është njoftuar Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse, e cila ka shpallur fituesin dhe në përfundim ka nxjerrë edhe aktin e emërimit për kandidatin e shpallur fitues.

Konkluzion: Komisioneri vëren se, procedurat e lëvizjes paralele janë realizuar në mbështetje të nenit 25, të ligjit për nëpunësin civil dhe në respektim të rregullave të përcaktuara në kreun VII, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe kreun II, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

- **Emërimet nëpërmjet ngritjes në detyrë,** (5 raste janë ngritje në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese dhe 2 raste, ngritje në detyrë në kategorinë e mesme drejtuese).

Nga verifikimi i dokumentacionit të venë në dispozicion, grupi i punës konstaton se nëpërmjet ngritje në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese janë bërë këto emërimet:

*****, me aktin nr. 107, dt. 12.01.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

*****, me aktin nr. 4595, dt. 29.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile”.

*****, me aktin nr. 4591, dt. 29.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Zhvillimit dhe Integritimit të Sistemeve”.

*****, me aktin nr. 5936, dt. 26.11.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Kordinator” në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara.

*****, me aktin nr. 4544, dt. 25.09.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Inspektor në Sektorin e Inspektimit”. Ky konkurrim për ngritje në detyrë, është kryer në zbatim të mundësisë që jep neni 26, pika 4 e ligjit, dispozitë e cila lejon procedurën e plotësimit të pozicionit të lirë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues, me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, mjaft që të mos tejkalohet përqindja e lejuar nga ligji (20 %), në raport me numrin e vendeve të lira të planifikuara për çdo vit kalendarik.

- Emërimet në kategorinë e mesme drejtuese nëpërmjet ngritjes në detyrë:

Rezulton se në kategorinë e mesme drejtuese, nëpërmjet ngritjes në detyrë janë bërë 2 emërimet. Në këtë rast bëhet fjalë për:

*****, me aktin nr. 5556, dt. 12.11.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik”.

*****, me aktin nr. 3437, dt. 06.11.2015, të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Integritimit Europian”.

Grupi i punës vëren se, nëpunësit *****, *****, *****, ***** dhe ***** kanë aplikuar për ngritje në detyrë, brenda të njëjtës institucion ku ishin të punësuar, ndërsa ***** ishte e punësuar në institucion varësie. Në momentin e aplikimit për ngritjes

në detyrë, nëpunësit ishin të konfirmuar në pozicionet përkatëse ku kryenin funksionet e tyre në shërbimin civil.

Konstatohet se, në 2 raste, pozicione të kategorisë së lartë drejtuese, janë plotësuar me anëtar të TND-së, më konkretisht:

*****, me aktin nr. 1573/1, dt. 23.04.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Njësisë Antitrafik*”. Aktualisht sipas kërkesës së institucioneve respektive dhe me pëlqimin paraprak të saj, me aktin nr. 3149/2, dt. 03.07.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Antitrafikut*”, që sipas strukturës në fuqi, është pozicion i kategorisë së mesme drejtuese.

*****, me aktin nr. 830, dt. 05.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile*”.

Konkluzion:

Procedurat e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur për 15 pozicionet e kategorisë ekzekutive, procedurat e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë për 7 pozicione të kategorisë së ulët apo të mesme drejtuese dhe procedurat për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së lartë drejtuese, janë kryer nga njësia përgjegjëse, që në këtë rast, është Departamenti i Administratës Publike, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës

Nëpunësit civil që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; kreun V të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe, kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil), dhe që kishin një periudhë punësimi më të vogël se një vit, në pikën 4, të nenit 67 të ligjit, është përcaktuar se, për ta zbatohet neni 24 i ligjit dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, grupi i punës verifikoi tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë të cilët i janë nënshtuar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punës me institucionin.

Nga verifikimet e kryera rezulton se, për periudhën e kontrolluar kanë përfunduar periudhën e provës:

- Nëpunësit e rekrutuar sipas procedurave konkurruese të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, por që në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, ishin nëpunës civil në periudhë prove.

- Punonjësit e emëruar me kontratë, por që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, ishin të punësuar në pozicionin përkatës të shërbimit civil, për një periudhë më pak se 1 vit.

- Nëpunësit e rekrutuar sipas procedurave konkurruese të ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, procedura të cilat fillimi i efekteve të ligjit, i gjeti në proces.

Nga verifikimi i dokumentacionit që na u vu në dispozicion rezulton se, gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s, konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr, të paktën 50 % të pikëve në testim. Nga verifikimi i vërtetimeve (*çertifikatave*) të lëshuara nga ASPA rezulton se, në testimin përfundimtar nëpunësit e nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues janë vlerësuar “*Përfundoi me sukses trajnimin*”, ndërsa nëpunësit e kategorisë së ulët drejtuese dhe nëpunësit e kategorisë ekzekutive janë vlerësuar me pikë, ku kanë marrë mbi 50 % të pikëve.

Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për vlerësimin e arritjeve vjetore.

Në këtë proces u konstatua se, është marrë edhe mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër.

Periudha e provës është përfunduar me nxjerrjen e vendimit për konfirmimin e nëpunësit civil. Vendimet e konfirmimit i janë njoftuar Departamentit të Administratës Publike në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

Konstatohet se, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, *janë 15 nëpunës civil të emëruar për herë të parë në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive, të cilët vazhdojnë periudhën e provës.*

Konkluzion: Mbështetur në parashikimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, për nëpunësit e nivelit ekzekutiv, të cilët janë aktualisht në periudhë prove, duhet të respektohen kërkesat ligjore:

- Nëpunësi është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

- Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër, nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

(Për nëpunësit që kanë përfunduar periudhën e provës , të dhënat lidhur me: kryerjen e ciklit të trajnimit pranë ASPA-s; vlerësimi i rezultateve individuale në punë; si dhe, akti i konfirmimit si nëpunës civil, janë pasqyruar në tabelën nr. 2 dhe nr. 3 që i bashkëlidhen raportit si pjesë e tij).

VI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin si dhe rastet e tjera të transferimit)

Kriteret bazë mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të nëpunësit civil në një pozicion tjetër të shërbimit civil, (*transfrimi i përkohshëm, arsyet e transferimit, kohëzgjatja e transferimit, transferimi i përhershëm, rastet kur zbatohet transferimi i përhershëm, transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*), janë përcaktimet e kreut VIII “*Transferimi në shërbimin civil*”, nenet nga 48 deri në 52 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; vendimi nr. 125, datë 17.02.2016 i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, (në rastin e kësaj mbikëqyrje edhe vendimi nr. 171, datë 26.3.2014 i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, i shfuqizuar, por që ka qenë në fuqi për gjithë periudhën objekt i mbikëqyrjes).

- Trasferimi i përkohshëm:

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, **vetëm 3 nëpunës civil**, janë transferuar përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, në interes të institucionit, rast ky i parashikuar në pikën 1, shkronja “a”, të nenit 48 të ligjit, (*2 nëpunës janë transferuar brenda institucionit ***** dhe ***** dhe një nëpunës është transferuar nga institucion varësie në ministri ******).

Më konkretisht konstatohet se:

Nëpunësja *****, me aktin nr. 2856/1, dt. 22.06.2015 të njësisë përgjegjëse (DAP-it), është transferuar nga pozicioni “*Përgjegjës në Sektorin e Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv-Protokollit*”, në Drejtorinë e Shërbimeve në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave*”, në Drejtorinë e Dokumentacionit dhe Procedurave. Afati i transferimit është përcaktuar deri në 6 muaj. Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësja ka aplikuar për t’u sistemuar në këtë vend pune, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, (*emëruar me aktin nr. 5398, dt. 05.11.2015*).

Nëpunësja *****, me aktin nr. 2856/2 prot., dt. 22.06.2015 të njësisë përgjegjëse (DAP-it), është transferuar nga pozicioni “*Specialist në Sektorin e Zbatimit të Buxhetit*” në Drejtorinë e Financave, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Aktiveve*”, në Drejtorinë e Financave. Afati i transferimit është përcaktuar deri në 3 muaj. Gjatë periudhës së transferimit,

nëpunësja ka aplikuar për t'u sistemuar në këtë vend pune, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, (emëruar me aktin nr. 4547, dt. 25.09.2015).

Nëpunësja *****, me aktin nr. 2856/3 prot., dt. 22.06.2015 të njësisë përgjegjëse (DAP-it), është transferuar nga pozicioni “Specialist në Sektorin e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”, në Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shtetësisë” në Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Afati i transferimit është përcaktuar deri në 3 muaj. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësja është kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës. Ndërkohë, ajo ka aplikuar për procedurat e lëvizjes paralele dhe në përfundim të tyre, me aktin nr. 4864, dt. 13.10.2015 të njësisë përgjegjëse (DAP-it), është emëruar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Shtetësisë” në Drejtorinë Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që është dhe pozicioni aktual në shërbimin civil.

- Transferimi i përhershëm:

Lidhur me transferimin e përhershëm, konstatohet se është zbatuar vetëm rasti i transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit, i parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërsa, transferimi i përhershëm për arsye të paaftësisë shëndetësore; transferimi i përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit dhe transferimi në përfundim të afatit apo zhdukjes së shkakut të pezullimit nëse pozicioni i mëparshëm i punës është plotësuar përfundimisht, të parashikuar nga neni 51, 52 dhe pika 1 e nenit 56 të ligjit, për periudhën e mbikëqyrur nuk janë aplikuar në asnjë rast.

- Transferimi për shkak të ristrukturimit të institucionit, (apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit).

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin vërejmë se: Me urdhrin nr. 70, datë 07.05.2015 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme”, është miratuar struktura dhe organika e re, për aparatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në pikën 2 të këtij urdhri, është përcaktuar numri i punonjësve të institucionit, gjithsej 175 veta. Gjithashtu, urdhri për miratimin e strukturës së re, ka shfuqizuar strukturën dhe organikën e vjetër të institucionit, të miratuar me urdhrin nr. 190, datë 18.10.2013 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Punëve të Brendshme”, të ndryshuar, (kjo strukturë organike ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit dhe grupi i punës e ka analizuar në mënyrë të detajuar në pikën I të raportit).

Nga krahasimi i strukturës së vjetër me strukturën e re konstatohet se:

Sipas strukturës dhe organikës së vjetër, institucioni kishte 154 pozicione pune gjithsej, ku sipas natyrës së funksioneve që kryenin 10 pozicione pune ishin funksione politike, 5 pozicione pune, ishin nëpunës me grada, 16 pozicione pune, kryenin funksione administrative dhe 123 pozicione kryenin funksione të shërbimit civil.

Sipas strukturës së re, institucioni ka 175 pozicione pune gjithsej, ku 10 pozicione pune, janë funksione politike (1 ministër + 2 zv/ministër + 1 drejtor kabineti + 6 këshilltar); 5 pozicione

pune, janë nëpunës me grada; *16 pozicione pune*, kryejnë funksione administrative (5 sekretare +2 arkivist/protokollist +1 arkivist +1 magazinier +5 pastrues +2 punëtor); dhe, **144 pozicione pune janë pozicione të shërbimit civil**.

Në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së re, janë shtuar 21 vende pune dhe shtesë të vendeve të punës ka vetëm ajo pjesë e organikës, që kryen funksione të shërbimit civil pasi, sipas strukturës së vjetër ishin 123 pozicione të shërbimit civil ndërsa me strukturën e re, janë 144 pozicione të shërbimit civil, (pra janë shtuar 21 pozicione pune të shërbimit civil).

Mënyrën e organizimit të vendeve të shërbimit civil sipas strukturës së re krahasuar dhe me strukturën e vjetër e kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

Pozicionet e shërbimit civil, sipas kategorisë	Emërtimi i pozicionit të punës, për çdo kategori	Numri i pozicioneve të punës, për çdo kategori (Sipas strukturës së vjetër)	Numri i pozicioneve të punës për çdo kategori (Sipas strukturës së re)
Nëpunës civilë të kategorisë së së lartë drjtuese	Sekretar i Përgjithshëm Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme	1 5	1 5
Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtues	Drejtor drejtorie	16	17
Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese	Përgjegjës sektori Koordinator Inspektor	10 12 6	15 13 5
Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialist	74	88
Nëpunës civilë gjithsej		123	144

Konstatohet se, për shkak të miratimit të strukturës së re, pozicionet e shërbimit civil kanë pësuar ndryshime jo vetëm në numër (janë shtuar 21 vende të reja) por, është shtuar edhe numri i njësive organizative pjesë përbërëse e institucionit, është shtuar një drejtori (struktura e re ka 17 drejtori nga 16 që kishte struktura e vjetër); është shtuar një sektor, (struktura e re ka 27 sektorë nga 26 që kishte struktura e vjetër).

Në strukturën e re, ish “Njësia Antitrafik”, ka ndryshuar emërtesën duke u bërë “Drejtoria e Përgjithshme e Antitrafikut dhe Azilit”, gjithashtu kjo drejtori është zgjeruar pasi i janë shtuar funksionet e azilit.

Disa pozicione pune janë rrikategorizuar në nivelin e pagës, një nivel më lartë krahasuar me nivelin e pagës që kishin me strukturën e vjetër. (Rikategorizim të vendeve të punës ka: Drejtoria Juridike 4 pozicione pune; Drejtoria e Komunikimit dhe IT-së 2 pozicione pune; Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët 2 pozicione pune; Drejtoria e Planifikimit dhe

Koordinimit të Emergjencave Civile 1 pozicion pune; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme 2 pozicione pune; Drejtoria e Financave 1 pozicione pune).

Konkluzion: Komisioneri arrin në përfundimin se, miratimi i strukturës së re, është shoqëruar me ristrukturim të institucionit pasi, ka shtim të vendeve të punës, riorganizim të strukturave organizative, disa vende pune kanë pësuar ndryshime dhe aplikimi i organikës së re është në përputhje me ligjin.

- *Procedurat e ndjekura për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit:*

Për të verifikuar procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit, u kërkua nga institucioni dokumentacioni përkatës, nga shqyrtimi i të cilit, rezulton se:

Pas hyrjes në fuqi të strukturës dhe organikës së re, Departamenti i Administratës Publike, me urdhrin nr. 43/1, datë 18.05.2015, “*Për krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme*”, ka krijuar komisionin e ristrukturimit.

Komisioni i ristrukturimit është krijuar me përbërje prej tre anëtarësh, një përfaqësues i njësisë përgjegjëse (DAP-it) si kryetar i komisionit, (***** me detyrë specialist në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve, në DAP) dhe dy përfaqësues të institucionit si anëtarë (***** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm dhe ***** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme).

Rezulton se, përfaqësuesi i institucionit, ***** (Sekretar i Përgjithshëm), për periudhën 11.05.2015 – 11.07.2015, ka qenë i pezulluar nga shërbimi civil, me kërkesë të tij, të miratuar nga njësia përgjegjëse (DAP-i). Për këtë arsye, në mungesë dhe me autorizim, ka vepruar nëpunësi ***** me detyrë “*Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile*”.

Komisioni i ristrukturimit pasi ka analizuar organikën e vjetër dhe organikën e re të institucionit, ka evidentuar strukturat organizative dhe pozicionet e punës të cilat prekeshin nga ristrukturimi. Për 50 nëpunësit që, iu kishte pësuar ndryshime pozicioni i mëparshëm i punës, komisioni ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të tyre në vendet e lira ekzistuese. Për këtë arsye, janë krahasuar përshkrimet e punës të nëpunësve me përshkrimet e punës të vendeve të lira, kriteret specifike të vendeve të lira dhe përputhshmëria e tyre me të dhënat e nëpunësve vendet e të cilëve kaluan në procesin e ristrukturimit.

Pas kryerjes së këtyre procedurave, komisioni i ristrukturimit, për nëpunësit e prekur nga ristrukturimi, ka propozuar me shkrim dhe në mënyrë individuale transferimin e tyre në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotësonte kërkesat specifike për pozicionin përkatës. Praktika e komisionit të ristrukturimit mbi bazën e së cilës është bërë propozimi për ripozicionimin e 50 nëpunësve, i është përcjellë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike. (*Praktika e Komisionit të ristrukturimit “Propozim për ristrukturim të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, shkresat nr. 2322/4 prot., datë 21.05.2015 dhe nr. 2322/28 prot., dt. 26.06.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar DAP-it*).

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, pasi ka marrë në shqyrtim propozimet e bëra nga Komisioni i Ristrukturimit, ka vendosur për transferimin e nëpunësve civilë në një pozicion tjetër të shërbimit civil brenda institucionit. Vendimet

individuale të transferimit i janë njoftuar çdo nëpunësi të prekur nga ristrukturimi dhe janë administruar në dosjet e personelit.

(Praktika shkresore e Departamentit të Administratës Publike, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, shkresat nr. 2124/3 prot., dt. 15.06.2015 dhe nr. 2124/57 prot., datë 06.07.2015).

Konkluzion: Duke marrë parasysh, gjithë sa parashtruam më sipër, arrihet në konkluzionin se:

- Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit dhe procedurat e kryera për transferimin e nëpunësve civilë, për shkak të ristrukturimit të institucionit, janë bërë në përputhje me përcaktimet e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe parashikimet e kreut III, të vendimit nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” si dhe, në respektim të procedurave të parashikuara në udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”.
- **Ristrukturimi i institucionit preku pozicionet e mëparshme të punës për 50 nëpunës civilë**, të cilët me transferim të përhershëm kanë kaluar në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, brenda institucionit.
- Nëpunësit civil të përfshirë në ristrukturim, në asnjë rast nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar të transferimit në kuadër të ristrukturimit.

VII. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste

Pezullimi apo ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies në shërbimin civil, (arsyet kur një nëpunës civil pezullohet; pezullimi i nëpunësit civil me kërkesë të tij; pezullimi i nëpunësit civil në rastin e procedimit disiplinor, kur besohet se vazhdimi i detyrës pengon hetimin administrativ; si dhe, efektet e pezullimit), janë të parashikuara në kreun IX “Pezullimi nga shërbimi civil”, nenet nga 53 deri 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 171, datë 26.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, që ka qenë i zbatueshëm për periudhën objekt kontrolli. (Aktualisht zbatohet vendimi nr. 124, datë 17.02.2016 i Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”).

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, grupi i punës konstaton se, për periudhën objekt i mbikëqyrjes, institucioni i kontrolluar, ka kryer 6 procedura të pezullimit nga shërbimi civil, ku:

- **në 5 raste**, nëpunësi civil është pezulluar me kërkesë të tij;
- **në 1 rast**, nëpunësi civil është pezulluar me vendim të komisionit disiplinor.
- Pezullime me kërkesë të nëpunësit:

Gjatë procesit të mbikëqyrjes rezultoi se, me kërkesë të bërë nga vetë nëpunësi kanë pezulluar marrëdhënien në shërbimin civil 2 nëpunës civilë anëtarë të TND-së, 2 nëpunës civil të kategorisë së mesme drejtuese dhe 1 nëpunës i kategorisë së ulët drejtuese.

Konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, për dy nëpunësit anëtarë të TND-së dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme e institucionit, për 3 nëpunësit e tjerë, me marrjen e kërkesës së nëpunësit, kanë proceduar duke konstatuar dhe miratuar vendimin e pezullimit. Vërejmë se, në këto raste është vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 55 të ligjit “Pezullimi me kërkesë të nëpunësit” dhe përcaktimet e kreut VI, pikat 39, 40 e 41 të vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

Në mënyrë më të detajuar pezullimet e konstatuara me kërkesë të nëpunësit, paraqiten si më poshtë:

Nëpunësi i pezulluar me kërkesë të tij	Miratimin i pezullimit. (shkresa nr./dt.)	Shkaku dhe afati i pezullimit.
***** Sekretar i Përgjithshëm	Miratuar nga DAP-i, me shkresën nr. 1555/1, dt. 30.04.2015.	Pezullim për periudhën 11 maj 2015 deri në 11 korrik 2015. Në përfundim të afatit është rikthyer në pozicionin e mëparshëm.
***** Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse	Miratuar nga DAP-i, me shkresën, nr. 3065/2, dt. 07.07.2015.	Pezullim me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet.
***** Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme	Miratuar nga DSHB, me shkresën nr. k-73/1, dt. 30.07.2015.	Pezullim me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet.
***** Kordinator në Sektorin Teknik, Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara	Miratuar nga DSHB, me shkresën nr. 6816/2, dt. 15.09.2015.	Pezullim me kërkesë të nëpunësit, për një periudhë deri në 2 vjet.
***** Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm	Miratuar me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 399/3, dt. 28.01.2016	Pezullim për një periudhë 2 vjeçare. (Me vendimin nr. 18, dt. 20.01.2016, të Këshillit të Ministrave është emëruar në pozicionin zëvendësministër i Punëve të Brendshme).

Konkluzion:

- Pezullimi i nëpunësve ***** dhe *****, anëtarë të TND-së, është bërë me kërkesë të paraqitur nga vetë nëpunësit dhe është miratuar nga DAP-i, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 53, pika 1, shkronja “b” dhe neni 55 si dhe, vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për

transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, kreu VI , pika 39 dhe 40.

- Pezullimi i nëpunësve *****, ***** dhe *****, është bërë me kërkesë të paraqitur nga vetë nëpunësit dhe më pas DSHB e institucionit të mbikëqyrur, ka konstatuar me shkrim pezullimin dhe ka njoftuar njësinë përgjegjëse (DAP-in), sipas vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, kreu VI, pika 39, 40 dhe 41.
- Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, i lihet detyrë që, për nëpunësit *****, *****, ***** dhe ***** në përfundim të afatit apo shkakut të pezullimit, të zbatojë përcaktimet e nenit 56 “*Efektet e pezullimit*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- *Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor:*

Konstatohet se:

Në një rast, pezullimi i ish punonjësit ***** është bërë në zbatim të vendimit të komisionit disiplinor, pasi është krijuar bindja se, vazhdimi i kryerjes së detyrës nga ky nëpunës, pengonte hetimin administrativ. Në këtë rast, pezullimi i nëpunësit civil është bërë në mbështetje të nenit 53, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Më konkretisht konstatohet se:

Për ish punonjës, ***** ka nisur procedimi disiplinor. Shkelja disiplinore, nuk është klasifikuar në shkeljet e lehta dhe për këtë arsye, eprori direkt i ka kërkuar Komisionit Disiplinor fillimin e ecurisë disiplinore. Komisioni disiplinor, në cilësinë e organit disiplinor, me vendimin e ndërmjetëm nr. 6816/8, datë 27.08.2014, ka vendosur pezullimin nga detyra të nëpunësit ***** për periudhën 22 tetor – 5 nëntor 2014. Për gjithë periudhën e pezullimit nëpunësi është paguar në masën 50 % të pagës së plotë. Vendimi për marrje mase disiplinore është kundërshtuar në gjykatë.

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e komisionit të përhershëm)

Gjatë procesit të mbikëqyrjes grupi i punës verifikoi procedurat administrative disiplinore të realizuara nga institucioni përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje, (nga fillimi i efekteve të ligjit deri në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes).

Shkelja e detyrimeve që e ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin civil, llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore, organi kompetent disiplinor dhe procedurat që duhet të ndiqen në një procedim disiplinor janë të përcaktuara në kreu X “*Disiplina në shërbimin civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nenet nga 57 deri në 61; në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”,

si dhe udhëzimin nr.1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Grupi i punës konstaton se, për periudhën objekt mbikëqyrje janë proceduar me masë disiplinore 10 nëpunës, njëri prej të cilëve është ndëshkuar me masë disiplinore në dy raste. (Nëpunësja ***** ish “Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave”, Drejtoria e Dokumentacionit & Procedurave, me vendimin nr. 3601/20, dt. 10.07.2015 i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me vendimin nr. 3370/14, dt. 03.09.2015 i është dhënë masa “Largim nga shërbimi civil”).

Duke patur parasysh klasifikimin që i është bërë shkeljes disiplinore të pretenduar konstatohet se:

- **4 procedura** disiplinore janë realizuar për “shkelje të lehta”;
- **3 procedura** disiplinore janë realizuar për “shkelje të rënda”.
- **4 procedura** disiplinore janë realizuar për “shkelje shumë të rënda”.

- Shkelje disiplinore të lehta:

Për shkelje disiplinore të lehta janë realizuar 4 procedura disiplinore, (për nëpunësit: *****

***** dhe *****).

Nëpunësin ndaj të cilit është zbatuar masa disiplinore, vendimin për marrje mase disiplinore dhe ushtrimin e të drejtës së ankimit në gjykatën kompetente, e kemi paraqitur në tabelën si më poshte:

Nëpunësi me shkelje disiplinore	Vendimi për marrje mase disiplinore, lloji i masës së zbatuar	Paraqitja e ankimit në gjykatën kompetente
***** Specialist në Drejtorinë Operacionale e Drejtim - Komandimit të Emergjencave	Vendim i epropolit direkt, nr. 7741/1, dt. <u>06.10.2014</u> , “Vërejtje”	Nuk është paraqitur ankim në gjykatën kompetente.
***** Specialist në Sektorin e Shtetësisë	Vendim i epropolit direkt, nr. 2737/44, dt. <u>11.11.2014</u> , “Vërejtje”	Nuk është paraqitur ankim në gjykatën kompetente.
***** ish Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave	Vendim i epropolit direkt, nr. 3601/20, dt. <u>10.07.2015</u> , “Vërejtje”	Është paraqitur ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë. Gjykaka vendosur rrëzimin e padisë. Nëpunësi ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit.
***** Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave	Vendim i epropolit direkt, nr. 3304/2, dt. <u>14.05.2015</u> , “Vërejtje”	Është paraqitur ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë. Gjykata ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit.

Në rastin e këtyre nëpunësve, shkelja disiplinore është klasifikuar si “shkelje e lehtë”, parashikuar nga shkronja “c” e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Më tej, mbështetur në përcaktimet e shkronjës “a”, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59 të ligjit, për nëpunësit si më sipër, eprori direkt përkatës, ka zbatuar masën disiplinore “Vërejtje”.

Në dy raste nëpunësit nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit, ndërsa në dy raste të tjera nëpunësit janë ankuar pranë gjykatës kompetente dhe çështja është në shqyrtim në gjykatën administrative të apelit.

Grupi i punës vëren se, për nëpunësit ***** dhe ***** që nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit, masat disiplinore të marra ndaj tyre janë masa disiplinore të pashuara, pasi nuk kanë kaluar afatet e shuarjes për shkak të ligjit, të parashikuara nga neni 61, pika 1, shkronja “a” e ligjit ku përcaktohet se: *Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit pas kalimit të këtyre afateve: a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a”, të nenit 58 të këtij ligji”.*

Ekzistenca e masës së mëparshme disiplinore “Vërejtje”, të pashuar vlerësohet si rrethanë rënduese në qoftëse kryhen shkelje të tjera disiplinore përgjatë kësaj periudhe.

- *Shkelje disiplinore të rënda:*

Konstatohet se, për shkelje disiplinore të rënda janë proceduar tre nëpunës, *****, *****, dhe *****. Eprori direkt i çdo nëpunësi, pasi ka bërë vlerësimin e shkeljes së pretenduar, e ka klasifikuar atë, si shkelje të rëndë dhe më pas e ka kaluar çështjen për procedim e për shqyrtim në komisionin disiplinor. Në këtë rast, eprori direkt ka vepruar në mbështetje të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 59 të ligjit ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencë të komisionit disiplinor”.*

Në mënyrë më të detajuar për secilin rast, evidentojmë si më poshtë:

1) *****, me detyrë “Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile”, me vendimin nr. 2931/35, datë 30.10.2014, të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “Mbajtja e 1/3 së pagës së plotë për një periudhë 3 mujore”, të parashikuar nga shkronja “b” e nenit 58 të ligjit. (Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 2931/27 prot., datë 13.10.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”).

2) *****, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile”, me vendimin nr. 2931/34, datë 31.10.2014 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën pagës për një periudhë deri në dy vjet”, të parashikuar nga shkronja “c”, e nenit 58 të ligjit. (Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 7853 prot., datë 02.10.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”).

3) *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Redaktimit Gjuhësor dhe Arkiv-Protokollit”, me vendimin nr. 9374/4, datë 31.12.2015 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën pagës për një periudhë

deri në dy vjet”, të parashikuar nga shkronja “c”, e nenit 58 të ligjit. (Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 9374 prot., datë 22.12.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”).

Nga verifikimet e kryera rezulton se, nëpunësit që kanë marrë masë disiplinore nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente, e drejtë kjo e përcaktuar në pikën 3, të nenit 41 të ligjit, ku parashikohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi që i cënon të drejtat dhe interes të tij të ligjshme në marrëdhënien e shërbimit civil”*.

Në këto kushte, masat disiplinore konsiderohen si masa të pashuara deri në plotësimin e afateve të përcaktuara në pikën 1, shkronja “b” të ligjit, ku në mënyrë të shprehur është parashikuar se: *“Masat disiplinore shuhen për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve: ... b) 3 vjet nga mbarimi i afatit, për të cilin është zbatuar masa e parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 58 të këtij ligji”*.

Për këto arsye, për nëpunësit *****, *****, dhe *****, ekzistenca e masës së mëparshme disiplinore të pashuar, vlerësohet si rrethanë rënduese, në qoftëse ata kryejnë shkelje të tjera disiplinore përgjatë kësaj periudhe.

- *Shkelje disiplinore shumë të rënda:*

Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57 të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil është, *“largim nga shërbimi civil”*, i parashikuar në shkronjën “ç”, të nenit 58 të ligjit.

Në institucionin e mbikëqyrur u konstatua se, *“largimi nga shërbimi civil”*, i parashikuar si ndëshkimi administrativ, më i rëndë për një nëpunës civil, është zbatuar në 4 raste.

Në mënyrë më të detajuar u konstatua se:

Për *****, me detyrë ish *“Specialist në Drejtorinë Operacionale të Drejtimit Komandimit”*, me vendimin nr. 6816/15, datë 18.09.2014 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore *“largim nga shërbimi civil”*. Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 6816/1 prot., datë 15.08.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, *“Mbi ngritjen e Komisionit Disiplinor”*.

Gjatë shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, komisioni i disiplinës ka marrë vendimin e ndërmjetëm nr. 6816/8, datë 27.08.2014, *“Për pezullimin nga detyra për periudhën 22 tetor – 5 nëntor 2014 të nëpunësit”*. Kjo vendimmarrje e komisionit disiplinor, është bërë në mbështetje të përcaktimeve të pikës 6, të nenit 59 të ligjit ku parashikohet se: *“Nëse ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të çënojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, komisioni disiplinor mund të vendosë pezullimin e nëpunësit civil ose të marrë çdo masë tjetër të përshtatshme, deri në marrjen e vendimit përfundimtar”*. Akti i largimit nga shërbimi civil, është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

Për *****, me detyrë ish “*Specialist në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët*”, me vendimin nr. 2737/31, datë 06.10.2014 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”. Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 2737/15 prot., datë 18.09.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Mbi ngritjen e Komisionit Disiplinor*”.

Akti i largimi nga shërbimi civil është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

Për *****, me detyrë ish “*Drejtor i Arkivit të Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme*”, me vendimin nr. 7424/16, datë 06.11.2014 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”. Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 7424/7 prot., datë 29.09.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Mbi ngritjen e Komisionit Disiplinor*”.

Akti i largimi nga shërbimi civil është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

Për *****, me detyrë ish “*Specialist në Sektorin e Mbikëqyrjes së Procedurave*”, me vendimin nr. 3370/14, datë 03.09.2015 të komisionit disiplinor, është marrë masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”. Komisioni disiplinor është ngritur me aktin nr. 5370/1 prot., datë 20.07.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm, “*Mbi ngritjen e Komisionit Disiplinor*”. Në marrjen e masës disiplinore komisioni disiplinor është bazuar edhe në ekzistencën e masës disiplinore të mëparshme “*Vërejtje*”, marrë me vendimin nr. 3601/20, datë 10.07.2015 të eprorit direkt, e cila ishte masë disiplinore e pashuar.

Akti i largimi nga shërbimi civil është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në gjykatën administrative të apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

IX. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit nga zyrtarët kompetentë

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë, është parashikuar në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Para ndryshimeve, kjo dispozitë e parashikonte vlerësimin e rezultateve në punë, si një proces që përsëritet çdo vit, ndërsa me ndryshimet e bëra është parashikuar që vlerësimi i rezultateve në punë realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik. Ndërsa, vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë.

Më tej, është miratuar vendimi nr. 109, datë 26.02.2014 i Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, në të cilin janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura; vlerësimin e

sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbush nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektiveve kryesorë të punës të nëpunësit që do të vlerësohet.

Gjatë verifikimit u konstatua se, *formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në lidhjen nr. 1 dhe lidhjen nr. 2*, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, ku janë të materializuara të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A), të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi; (ndarja B), objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv; (ndarja C), sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnimin dhe ngritjen profesionale; (ndarja Ç), vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektiveve kryesorë të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, punonin në pozicione pune të konsideruara pjesë e shërbimit civil, grupi i punës verifikoi vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2014 dhe gjashtëmujorin e parë dhe të dytë të vitit 2015.

Duke patur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar i nëpunësve, paraqitet si më poshtë:

Periudha e vlerësimit	Niveli i vlerësimit përfundimtar	Numri i nëpunësve të vlerësuar për çdo nivel
Nëntor 2013 – Dhjetor 2014	shumë mirë	17 nëpunës
	mirë	47 nëpunës
	kënaqshëm	19 nëpunës
	jokënaqshëm	6 nëpunës
Janar – Qershor 2015	shumë mirë	28 nëpunës
	mirë	40 nëpunës
	kënaqshëm	22 nëpunës
	jokënaqshëm	1 nëpunës
Korrik – Dhjetor 2015	shumë mirë	22 nëpunës
	mirë	44 nëpunës
	kënaqshëm	24 nëpunës
	jokënaqshëm	4 nëpunës

Nëpunës të vlerësuar në nivelin “jokënaqshëm”:

- për vitin 2014 janë 6 nëpunës, (***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe *****);
- për 6 mujorin e parë të vitit 2015, është 1 nëpunës, (*****); dhe,
- për 6 mujorin e dytë të vitit 2015, janë 4 nëpunës, (***** , ***** , ***** dhe *****).

Grupi i punës verifikoi më tej, për të parë nëse këta nëpunës ndodhen ose jo në kushtet e pikës 1, shkronja “c”, të nenit 66 ku parashikohet se:

“Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet lirimit nga shërbimi civil në rastet:

- a) ...,
- b) ...,
- c) *Pas dy vlerësimeve “jokënaqshëm”, të rezultateve në punë; ... ”*

Nga verifikimet rezultoi se, nëpunësit e sipërpërmendur, nuk ndodhen në kushtet që parashikon kjo dispozitë pasi, vetëm nëpunësja ***** , ka dy vlerësime “*Jokënaqshëm*”, por këto vlerësime nuk janë të njëpasnjëshëm, ndërsa nëpunësit e tjerë kanë vetëm 1 vlerësim “*Jokënaqshëm*”.

Sjellim në vëmendje të nëpunësve të ngarkuar me menaxhimit e burimeve njerëzore se, vlerësimi i fundit i rezultateve në punë, në nivelin “*Mirë*” apo “*Shumë mirë*”, është parashikuar si një nga kushtet minimale që duhet të plotësojë një kandidat që aplikon për procedurën e lëvizjes paralele dhe procedurën e ngritjes në detyrë. (VKM nr. 243, dt. 18.03.2015, kreu VII, pika 2, shkronja “c” dhe VKM nr. 242, dt. 18.03.2015, kreu kreu II, pika 1, shkronja “c” dhe kreu III, pika 2, shkronja “c”).

Ndërsa, nëpunësit që e kanë vlerësimin e fundit “*Kënaqshëm*” apo “*Jokënaqshëm*”, nuk plotësojnë kushtet minimale për të marrë pjesë në këto procedura.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2015, një nëpunës nuk është përfshirë në procesin e vlerësimit. Në këtë rast bëhet fjalë për nëpunësin ***** , me detyrë “*Specialist në Sektorin e Planifikimit & Monitorimit*”, emëruar në këtë pozicion në datën 25.09.2015, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Për punonjësen në fjalë, në momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, bashkë me dokumentet e tjera që përmban dosja e personelit duhet të ishte administruar edhe vlerësimi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 dhe një vlerësim i pjesshëm për periudhën korrik-shtator 2015. Më tej, vlerësimi për periudhën tetor-dhjetor 2015 duhet të ishte kryer nga institucioni i mbikëqyrur, bazuar në realizimin e objektivave të vendit të punës, me të cilat nëpunësja është njohur që në momentin e fillimit të detyrës.

Për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues, anëtar të TND-së, vlerësimet e rezultateve në punë për 6 mujorin e dytë të vitit 2015 janë në proces. Për këtë arsye, i lihet detyrë njësisë përgjegjëse që të përfundojë vlerësimin e rezultateve në punë për këta nëpunës.

Konkuzion:

- Komisioneri vlerëson se, institucioni i kontrolluar i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar.
- Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së vlerësimit, apo në përfundim të periudhës së provës, është miratuar nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit, duke plotësuar në mënyrën e duhur të gjithë elementet formalë të kërkuar nga formulari i vlerësimit. Konstatohet se në vlerësimin e nëpunësve të përfshirë në këtë proces, janë përdorur të katër nivelet e parashikuara në sistemin e vlerësimit, (nga niveli 1 deri në nivelin 4), çka tregon se janë bërë përpjekje serioze për një vlerësim objektiv të punonjësve.
- I lihet detyrë institucionit të mbikëqyrur, që, vlerësimet e rezultateve në punë të bëra për nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese, anëtar të TND-së, *****, *****, ***** dhe *****, t’i dërgohen zyrtarisht njësisë përgjegjëse. Pas kësaj, njësia përgjegjëse në respektim të procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, të drejtojë procesin në mënyrë që për këta nëpunës të bëhet vlerësimi përfundimtar i rezultateve në punë.

X. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të liritimit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se, lirimi nga shërbimi civil është zbatuar vetëm në rastet e paraqitjes së dorëheqjes nga detyra, rast ky i parashikuar në shkronjën “dh”, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Vemë re se, për periudhën objekt mbikëqyrje, janë 15 nëpunës të larguar nga detyra si pasojë e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje nga vetë nëpunësi. Në mënyrë më të detajuar rastet e liritimit nga shërbimi civil, si pasojë e dorëheqjes, janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Nëpunësi i larguar me dorëheqje Emër/Mbiemër/Emërtesa e pozicionit të punës	Akti i emërimit në shërbimin civil	Vendimi për lirim nga shërbimi civil	Arsyet e liritimit nga shërbimi civil
1	***** Drejtor, Drejtoria e Planifikimit Strategjik për Sigurinë Publike dhe Integrimin	Akt i DAP, nr. 323/7, dt. 12.02.2014	Vendim i DSHB, nr. 2582/2, dt. 01.04.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
2	***** Specialist, Sektori i Koordinimit dhe Raportimit të Politikave Integruese	Akt i DAP, nr. 20/6, dt. 09.03.2007	Vendim i DSHB, nr. 2679/1, dt. 18.04.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.

3	***** Specialist, Sektori i Koordinimit të Projekteve dhe Fondeve IPA	Akt i DAP, nr. 2854/9, dt. 30.06.2008	Vendim i DSHB, nr. 4632/2, dt. 22.06.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
4	***** Drejtor, Drejtoria e Marrëveshjeve	Akt i DAP, nr. 1459/7, dt. 20.09.2012	Vendim i DSHB, nr. 1291/3, dt. 10.03.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
5	***** Drejtor, Njësia Antitrafik	Akt i DAP, nr. 47/1, dt. 19.01.2006	Vendim i DSHB, nr. 1083/2, dt. 28.03.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
6	***** Koordinator, Njësia Antitrafik	Akt i DAP, nr. 748/11, dt. 27.06.2011	Vendim i DSHB, nr. 2700/1, dt. 28.04.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
7	***** Koordinator, Njësia Antitrafik	Akt i DAP, nr. 1384, dt. 29.12.2006	Vendim i DSHB, nr. 5376/3, dt. 20.07.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
8	***** Specialist, Sektori i Menaxhimit të Aktiveve	Akt i DAP, nr. 3135/7, dt. 13.08.2008	Vendim i DSHB, nr. 999/8, dt. 04.09.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
9	***** Specialist, Sektori i Zhvillimit të Burimeve Njerëzore	Akt i DAP, nr. 851/10, dt. 28.07.2010	Vendim i DSHB, nr. 5661/2, dt. 30.07.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
10	***** Specialist, Sektori Juridik	Akt i DAP, nr. 1729/8, dt. 04.03.2013	Vendim i DSHB, nr. 2205/2, dt. 28.03.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
11	***** Specialist, Sektori i Përfaqësimit dhe Përafrimit të Legjislacionit	Kontratë nr. 2695, dt. 20.09.2010	Vendim i DSHB, nr. 6802/2, dt. 15.09.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
12	***** Specialist për TI, Drejtoria e Komunikimit & TI-së	Akt i DAP, nr. 1486/12, dt. 24.12.2012	Vendim DSHB, nr. 6763/2, dt. 07.09.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
13	***** Drejtor i Përgjithshëm i Gjendjes Civile	Akt i DAP nr. 2007/7, dt. 20.01.2014	Vendim i DAP, nr. 5158/3, dt. 30.07.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra

14	***** Specialist, Sektori i Mbështetjes Operacionale dhe Trajnimeve	Akti i DAP, nr. 2371/8, dt. 22.02.2011	Vendim i DSHB, nr. 10187/2, dt. 31.12.2014	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.
15	***** Specialist, Sektori i Administrimit të Sistemit të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile	Akti i DAP, nr. 614/1, dt. 25.02.2014 (emërim nga lista e pritjes)	Vendim i DSHB, nr. 2535/2, dt. 16.04.2015	Me kërkesë të nëpunësit për dorëheqje nga detyra.

Në këto raste, nëpunësit kanë paraqitur kërkesë për të ndërprerë marrëdhënien e punës me pozicionin përkatës të shërbimit civil, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim.

Rezulton se, lirimi nga shërbimi civil për 14 nëpunës, të kategorisë ekzekutive dhe të mesme drejtuese është bërë me vendim të njësisë së burimeve njerëzore, (*Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme*), ndërsa lirimi nga shërbimi civil për një nëpunës anëtarë të TND-së është deklaruar me vendim të Departamentit të Administratës Publike. Për të gjitha vendimet e lirimit nga shërbimi civil, njësia e burimeve njerëzore, ka vënë në dijeni Departamentin e Administratës Publike.

Me ligjin nr. 178/2014, "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"*", dispozita që rregullon institutin e dorëheqjes, (*neni 64*), ka pësuar ndryshime, që kanë hyrë në fuqi në datën 29.01.2015, (*botuar në Fletoren Zyrtare-viti 2014, numri 211, datë 14.01.2015, hyrja në fuqi është përcaktuar 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare*).

Si pasojë e këtyre ndryshimeve, tashmë neni 64 i ligjit për nëpunësin civil, përcakton se:

"Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil".

Pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi, janë miratuar dorëheqjet për nëpunësit *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, dhe *****. Por, 3 nëpunës nuk përfitojnë nga e drejta e përcaktuar në dispozitën si më sipër, (***** në momentin e dorëheqjes nuk ishte konfirmuar si nëpunës civil, ndërsa ***** nuk i është kryer deklarimi i statusit të punësimit, ***** nuk ishte konfirmuar nëpunës civil).

Të tjera:

- Emërimet në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë:

*****, me aktin nr. 2751/2, dt. 22.10.2014 të Departamentit të Administratës Publike, në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për rikthim në detyrë, është emëruar në pozicionin "*Koordinator*", në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara. (*Emërimi në këtë pozicion është bërë, në zbatim të vendimit nr. 39, datë 21.04.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

- *Nëpunës që kanë ndërperë marrëdhënien e punësimit me institucionin, pasi kanë kaluar në institucione të tjera, nëpërmjet lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë.*

*****, me detyrë ish “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Juridike”, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 804/7, dt. 15.06.2009 të DAP-it, me urdhrin nr. 62, dt. 29.02.2016 të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, është emëruar në pozicionin “Ndhmëskomisioner” pranë këtij institucioni.

*****, me detyrë ish “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritimit”, emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 203/8, dt. 05.02.2014 të DAP-it, me aktin nr. 884/12 prot., dt. 15.03.2016 të Departamentit të Administratës Publike, është emëruar në pozicionin “Drejtor i Njësisë së Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave” në Departamentin e Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj, në Kryeministri.

- *Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes:*

Bazuar në strukturën dhe organikën në fuqi, në momentin e mbikëqyrjes aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka 144 pozicione të shërbimit civil. Duke parë mënyrën e plotësimit të tyre konstatohet se:

- 85 pozicione të shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës dhe punonjës ekzistues ku, 77 nëpunës janë të rekrutuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe 8 punonjës janë nëpunës civil për shkak të ligjit.
- 28 pozicione të shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës të rekrutuar sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
- 31 pozicione të shërbimit civil, (21%), janë vende të lira, nga të cilat 3 pozicione janë të kategorisë së lartë drejtuese, 5 pozicione janë të kategorisë së mesme drejtuese, 9 pozicione janë të kategorisë së ulët drejtuese dhe 15 pozicione janë të kategorisë ekzekutive.

XI. Dosjet e personelit

Grupi i punës këqyri dosjet e personelit për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se, në të janë të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës*

së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore; etj.

Në një rast u konstatua se, nëpunësi ka dorëzuar vetëm vërtetim për përfundimin e programit të studimeve. Për këtë arsye, në projektraport u la detyrë që, në dosjen e personelit të nëpunësit ***** , të administrohet diploma e shkollës së lartë dhe lista e notave.

Nisur nga observacionet e paraqitura nga institucioni si dhe aktet bashkëlidhur tyre, Komisioneri vëren se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur na është vënë në dispozicion një dokument i barasvlefshëm me diplomën, në formë vërtetimi i lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe bashkëlidhur tij një certifikatë notash me nr. 2100 prot., datë 18.09.2015. Pra, nga ana e institucionit janë marrë masat në lidhje me përfshirjen në dosjen e personelit të nëpunësit ***** , të dokumentit vërtetim që është i barasvlefshëm me diplomën e arsimit të lartë.

*(Të gjitha aktet që përmbajnë të dhënat, që duhet të përmbajë dosja teknike e nëpunësit, janë të pasqyruara në **Aneksin**: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në aparatit e Ministrisë së Punëve të Brendshme”).*

Nga këto të dhëna, konstatohet se, nga 113 nëpunës civilë që ka institucioni i mbikëqyrur, **60 %** e tyre janë femra, dhe **40 %** janë meshkuj, ndërkohë që, moshë mesatare e nëpunësve civilë është **38** vjeç.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se:

- **98 nëpunës**, kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike;
- **6 nëpunës**, kanë kryer arsimin e lartë në institucione private;
- **9 nëpunës**, kanë mbaruar arsimin e lartë në institucione arsimore jashtë Republikës së Shqipërisë. Diplomat janë njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, i cili është institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave.

Konkluzion:

Nga mbikëqyrja konstatohet se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Arkiv - Protokollit.

a. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Regjistri Qendror i Personelit, krijohet dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike. Në kushtet kur ky regjistër, ende nuk është bërë funksional, rezulton se, të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt. Grupi i punës, vlerëson punën e mirë të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, si dhe në organizimin e dosjeve individuale të nëpunësve civilë, si përsa i përket sistemimit ashtu edhe përmbajtjes së tyre.

*

* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, duke filluar nga shtrirja e efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Komisioneri, vlerëson punën e mirë të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, si dhe në organizimin e dosjeve individuale të nëpunësve civilë, si përsa i përket sistemimit ashtu edhe përmbajtjes së tyre.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

Aneksi: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil, në aparatit e Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Tabela nr. 1: “Punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ishin të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil dhe që janë rekrutuar dhe konfirmuar sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Tabela nr. 2: “Punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ishin të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, që janë rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe që ishin nëpunës civilë në periudhë prove”.

Tabela nr. 3: “Punonjësit që në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ishin të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, dhe që janë rekrutuar me kontratë pune, ose akt emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Tabela nr. 4: “Nëpunës të rekrutuar me konkurrim, sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar”.

Njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA